



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 600/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), me seli në Kamenicë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET ankesa si e pabazuar e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjektit politik LVV, ne te cilën pretendohet se “më datë 12.12.2010, në fshatin Poliçkë komuna e Kamenicës, në shkollën fillore “Kadri Zeka” ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit sepse kanë ardhur me vetura shumë persona të cilët kanë votuar më kusht; dyshohet për votime të dyfishta. Parashtruesi i ankesës thekson se në rastin konkret është bërë shkelje e nenin 57 paragrafi 3 i LZP-së”.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar dëshmi për të besuar se në shkollën fillore “Kadri Zeka” fshatin Poliçkë komuna e Kamenicës, ka pasur votime të dyfishta dhe shume persona kane votuar me kusht. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 600/2010 më datën 15.12.2010.

